



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/95

Datë: 16.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 16 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Shfuqizohet vendimi i Qeverisë nr. 02/92 i datës 10 qershor 2016 dhe vendimi nr. 01/93 i datës 13 qershor 2016.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/95

Datë: 16.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 16 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjeve që ndërlidhen me Mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Republikën e Kosovës.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Shfuqizohet vendimi i Qeverisë nr. 03/92 i datës 10 qershor 2016.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/95

Datë: 16.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 21 të Ligjit Nr. 03/L-175 për Borxhet Publike, të nenit 8, paragrafi 6 i Rregullores QRK-NR 22/2013 mbi Procedurat për Emetimin dhe Menaxhimin e Borxheve Shtetërore, Garancive Shtetërore dhe Borxheve Komunale, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 16 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

për dhënien e garancisë shtetërore për marrjen e kredisë nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e Ndërmarrjes Publike Trafiku Urban

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Financave për dhënien e garancisë shtetërore për marrjen e kredisë në shumë prej 10 milion € për projektin e Ndërmarrjes Publike Trafiku Urban.
2. Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, Dokumenti i Garancisë Shtetërore duhet të nënshkruhet në emër të Republikës së Kosovës nga Ministri i Financave.
3. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimit, konform Ligjit Nr. 03/L-175 për Borxhet Publike.
4. Ky vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/95

Datë: 16.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7. paragrafi 5 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 16 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

për rekomandimin e Presidentit të Republikës së Kosovës për autorizimin e Ministrit të Financave për nënshkrimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për dhënien e garancisë shtetërore për projektin e Ndërmarrjes Publike Trafiku Urban

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Financave për t'i rekomanduar Presidentit të Republikës së Kosovës nga Qeveria e Republikës së Kosovës për autorizimin e Ministrit të Financave për nënshkrimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për dhënien e garancisë shtetërore për projektin e Ndërmarrjes Publike Trafiku Urban.
2. I Rekomandohet Presidentit të Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit për nënshkrimin e marrëveshjes nga paragrafi 1 i këtij vendimi, konform afatit të përcaktuar në nenin 7 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Ky vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë